FICADEX ALBANIA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Auditimi i Pasqyrave financiare

Viti fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2014

Partia "PËR EUROPIANIZIM DHE INTEGRIMIN E SHQIPËRISË

Adresa: Rruga "Komuna e Parisit", P, Haëai", kt. III, Tiranë

Subjekti - Parti Politike

Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë

Adresa: Rruga "Komuna e Parisit", P, Haëai", kt. III, Tiranë

Audituar nga:

Marije DUSHI

"FICADEX ALBANIA" Ltd

" Migjeni" street ,147 Q. 4, Durres - Albania;

Tel/fax + 355 52 37 859

Misioni

Auditimi i fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin fiskal 2014

Raporti

Data 17 Tetor 2015

Versioni: Final

Deklaratë përgjegjësie

Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë, Parti Politike, ka deklaruar se për vitin 2014 nuk ka aktivitet, pasi është krijuar në30 Dhjetor 2014. Si rezultat, nuk jemi në kushtet e auditimit sipas SNA.

"FICADEX ALBANIA" Ltd
Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania
Mobile: + 355 69 40 52 787
Tel/fax : + 355 52 2 37 859
E-mail : alficadex@gmail.com; alficadex@hotmail.com; mariadushi@gmail.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Pallati i kongreseve, Tiranë

Me vendimin nr. 969, datë10 Gusht 2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jemi caktuar me short për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin fiskal 2014, për Subjektin Zgjedhor "Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë", dhe kemi lidhur kontratën nr.7688 Prot., datë 25.09.2015.

Mungesa e ekzistencës së kushtve për një auditimi ligjor sipas SNA

1) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 23 Prot., datë 06.10.2015, Gjykata e Rrethit Tiranë (Regjistrit), me shkresën Nr. 12 650/1 Prot., datë 14.10.2015, na informoi se Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë, është krijuar në 03 Nëntor 2014. Personalitetin juridik e ka fituar me regjistrimin e saj në Regjistrin e Partive Politike, me vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë Nr. 12418, datë 29 Dhjetor 2014, i cili është i ankimueshëm 15 ditë nga data 30.12.2014 (e nesërmja e vendimit).
2) Në përgjigje të kërkesës tonë nr. 24 Prot., datë 12.10.2015, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRTT), me shkresën Nr. 72739 Prot., datë 16.10.2015, na informoi se Partia "Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" nuk është regjistruar në organet e tatimeve si detyrim i kërkuar nga neni 40, pika 4/4.1.a dhe neni 42, i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), detyrim i cili i lind në Janar të vitit 2015.
3) "Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" nuk ka detyrim ligjor për hartiinin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2014, pasi nuk ka ekzistuar.

Refuzim për të dhënë opinion

Për shkak të mosplotësimit të kushteve për një auditim ligjor siç përshkruhet në paragrafin *"Mungesa e ekzistencës së kushtve për një auditimi ligjor sipas SNA "*, ne nuk mund të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare të Partisë Politike "Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë".

Tiranë 17 Tetor 2015

Marije DUSHI - EKR

FICADEX ALBANIA SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.Regj.Them 15789 **Nr. 12418 Vendimi**
Data e Regjistrimit 05/12/2014 **Data 29.12.2014**

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

REXHINA MERLIKA - GJYQTARE

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Manjola Islamaj ne Tirane sot më datë 29.12.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me Nr.15789 Akti që i përket:

KËRKUES: **Rivelino ÇUNO**, i biri i Kristos, lindur në Delvinë më dt.26.07.1987, banues në Tiranë, Kryetar i Partisë "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë", identifikuar me nr. ID **I70726060B**

OBJEKTI: Regjistrimin si person juridik i Partisë "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" dhe depozitimin e akteve te partise ne rregjistrin e partive politike .

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.8580 datë17.02.2000 "Për Partitë Politike", Ligji Nr.10374, datë 10.02.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", të ndryshuar.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi perfaqesuesin e kërkuesit i cili ne perfundim te gjykimit kërkoi pranimin e kërkesës si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N

Se nga kërkuesi Rivelino ÇUNO, është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kërkesë me objekt regjistrimin si person juridik të partisë "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë", me inicialet "PEISHSH".

Sipas Vërtetimit dt 24.12.2014 të Zyrës së Regjistrit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton e provuar se emrin dhe inicialet e kësaj partie nuk i ka ndonjë parti tjetër e regjistruar.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se në mbledhjen e datës 03.11.2014, të anëtarëve themelues, pasi është diskutuar Statuti dhe Programi i partisë, në unanimitet është vendosur: Themelimi i Lëvizjes Politike "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" me inicialet "PEISHSH", miratimi i Statutit të saj, miratimi i organeve të paradrejtuese të saj si dhe është zgjedhur si kryetar partie z. Rivelino ÇUNO.

Sipas dokumentacionit të paraqitur pranë Gjykatës rezulton se kjo parti është një organizatë politike, e pavarur, e hapur dhe e gjithë veprimtaria e saj është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi dhe objektivat kryesore të kësaj partie të përcaktuara në Aktin e Themelimit, Statutin dhe Programin e saj, janë:

Partia Per Europianizim dhe Integrim ka për qëllim konkurimin politik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, në respekt të vlerave të lirisë, barazisë e drejtësisë në një garë politike. Ajo synon të promovojë në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve, lirinë e mendimit dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, zhvillimin e nismës së lirë e barazinë në shans, tregun e lirë e konkurues si instrument për zhvillimin e shpejtë dhe të qendrueshëm të vendit, shtetin e së drejtës, sigurinë e individit dhe të pronës, përgjegjësinë individuale e fuqizimin e familjes, drejtësinë shoqërore e dialogun social, ruajtjen e natyrës dhe të ambientit, autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen e lirë të komuniteteve lokale.

Partia Per Europianizim dhe Integrim do të kujdeset që të ndërtojë një shoqëri demokratike, tëpromovojë zhvillimin ekonomik, t'i adresojë problemet sociale dhe kulturore të komunitetitEgjiptian dhe Rom, të promovojë edukimin institucional, të luftojë në mënyrë demokratike dhe në pajtimme ligjin, kundër çdo lloj forme të diskriminimit ndaj komunitetit Egjiptian dhe Rom në Shqipëri, integrimin e komunitetit Egjiptian dhe Rom në Shqipëri dhe jashtë saj, të punojë në kthimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhësuar në Shqipëri dhe do të zhvillojë bashkëpunim të ngushtë me komunitetet e marzhinalizuara.

Partia Per Europianizim dhe Integrim inkorporon dhe promovon të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e Organizata e Kombeve të Bashkuara, Konventën Ndërkombëtare mbi të drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare të Drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe konventave të tjera ndërkombëtare dhe regjionale me karakter të tillë si dhe të ngjashme në pajtim me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Të punojë me organizata dhe parti politike të cilat kanë program të ngjashëm me Partinë Per Europianizim dhe Integrim për inicimin dhe promovimin e demokracisë në mes të popujve që jetojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Të punohet drejt integrimit në tërësi të komunitetit Egjiptian dhe Rom me shtetësi të Republikës së Shqipërisë dhe thellimin e bashkëpunimit me komunitetin egjiptian dhe Rom jashtë Shqipërisë.

Të ndihmojë Shqipërinë në integrimet evropiane dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Të ndihmojë në zhdukjen e getoizimit të egjiptianëve në Shqipëri.

Të ndihmojë, fuqizojë dhe inkurajojë të rinjtë egjiptian dhe rom që të jenë në gjendje të avancohen nëpozita të ndryshme ekzekutive dhe politike në institucionet e Republikës së Shqipërisë,shoqërisë civile dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare në botë.

Të ndihmojë në krijimin e një strukture të fuqishme lobiste në botë për fuqizimin e komunitetit egjiptian dhe rom.

Të bashkëpunojë me komunitetet tjera minoritare dhe komunitetin shumicë në Shqipërinë zgjedhjen e problemeve të përbashkëta.

Të koordinojë dhe të angazhojë ekspertë të komunitetit egjiptian dhe rom nëpër botë për tëfuqizuar komunitetin brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Të ndihmojë në organizimin e teorive, mendimeve, dhe publikimeve shkencore që ka të

bëjë me historinë e komunitetit dhe hulumtimin e mëtejshëm të prejardhjes etnike .

Të punojë dhe bashkëpunojë me organizatat tjera politike brenda dhe jashtë Shqipërisë simotra me orientime të demokracisë.

Të anëtarësohet PartinëPer Europianizim dhe Integrim në asociacione të ndryshme ndërkombëtare me orientime të demokracisë.

Të mbrojë dhe kultivojë vlerat fetare të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Të zhvillojë politika të mirëfillta për një jetë më të dinjitetshme për komunitetin Egjiptian dhe Rom të Shqipërisë.

Simboli i PEISH është në formë rrethore ku në mes të saj është Harta e Europës, në krahun e djathtë të së cilës është mbivendosur simboli i shqiponjës dykrenare, sipër

së cilës shkruhet "PEISH", dymbëdhjetë yjet e Bashkimit Europian, në formë rrethore dhe në rrethin e jashtëm, shkruhet "Partia për Europianizim dhe Integrim". Ky simbol përdoret nga organet përfaqësuese të PEISH ose me autorizim të tyre.

Flamuri i PEISH,është në formë rrethore ku në mes të saj është Harta e Europës, në krahun e djathtë të së cilës është mbivendosur simboli i shqiponjës dykrenare, sipër së cilës shkruhet "PEISH", dymbëdhjetë yjet e Bashkimit Europian, në formë rrethore dhe në rrethin e jashtëm, shkruhet "Partia për Europianizim dhe Integrim".

Vula e PEISH,është në formë rrethore ku në mes të saj është Harta e Europës, në krahun e djathtë të së cilës është mbivendosur simboli i shqiponjës dykrenare, sipër së cilës shkruhet "PEISH", dymbëdhjetë yjet e Bashkimit Europian, në formë rrethore dhe në rrethin e jashtëm, shkruhet "Partia për Europianizim dhe Integrim".

Vula përdoret vetëm në emër të Organeve Qendrore të PEISH dhe administratës ekzekutive të Selisë Qendrore. Degët e PEISH në rrethe kanë vulat e tyre që ruajnë modelin e mësipërm duke shtuar emrin përkatës të degës. Rregullat e përdorimit të vulës caktohen nga Kryesia.

PEISHSH angazhohet për integrimin e shpejtë të Shqipërisë në organizmat europiane e euroatlantike si dhe për një rrezatim pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë, për përjetësimin e kombit shqiptar, të identitetit dhe kulturës së tij.
PEISH bashkon rreth saj të gjithë shqiptarët që i përmbahen këtyre aspiratave dhe objektivave. PEISH garanton shprehjen e lirë të sensibiliteteve politike që e përbëjnë atë. Ajo bazohet në respektin e paritetit gjinor në jetën e partisë dhe në pjesëmarrjet zgjedhore e ekzekutive.
Organet drejtuese qëndrore të "Partia Per Europianizim dhe Integrim" janë: Kuvendi i Partisë; Këshilli Kombëtar; Kryetari; Sekretari i përgjithshëm; Nënkryetarët; Kryesia e PEISH;

Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike si dhe nga çdo burim tjetër jo publik që autorizon ai.

Numri i anëtarëve të saj është 3,560 anëtarë themelues, të cilët kanë dëshirë dhe vullnetin e tyre të lirë e të plotë për themelimin e saj dhe pranojnë statutin dhe programin e saj.

Për sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 306 e vijues të K.Pr.Civile.

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës.
- Rregjistrimin si person juridik të partisë "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë".
- Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë është një organizatë politike, e pavarur, e hapur dhe e gjithë veprimtaria e saj është në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Qëllimi dhe objektivat kryesore të kësaj partie janë të përcaktuara në Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Organet drejtuese qëndrore të PEISH janë: Kuvendi i Partisë; Këshilli Kombëtar; Kryetari; Sekretari i përgjithshëm; Nënkryetarët; Kryesia e PEISH;.
- Kryetari i Partisë i zgjedhur në mbledhjen e themeluesve të dt. 03.11.2014 është Z. Rivelino ÇUNO.
- Shpërbërja e saj bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
- Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike si dhe nga çdo burim tjetër jo publik që autorizon ai.
- Emri i plotë i partisë është Partia "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" dhe inicialet e saj janë "PEISH".
- Selia qëndrore e Partisë, "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" ndodhet në Tiranë në adresën: në Rruga "Komuna e Parisit", Pallatet Hawai, Kati 3, Tiranë.
- Partia "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë", ka flamurin, emblemën dhe vulën e saj.

- Numri i anëtarëve të saj është 3,560 shtetas shqiptarë.
- Urdhërohet Zyra e Regjistrit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të bëjë regjistrimin e Partisë "Partia Për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë" dhe depozitimin e akteve përkatëse.
- Shpenzimet gjyqësore ne masen 800 leke në ngarkim të kërkuesit.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 29.12.2014 ora 08.50.

SEKRETARE

MANJOLA ISLAMAJ

GJYQTARE

REXHINA MËRLIKA